



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 21 Prill 2021

Nr. 269

VENDIM

Objekt: Për shqyrtimin administrativ të denoncimit të Partisë Demokratike, për shkelje të parashikuara në udhëzimin nr. 6, datë 23.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ndaj kandidatit për deputet z. Bledi Çuçi

Kërkues: Partia Demokratike

Ndaj: Kandidatit për deputet z. Bledi Çuçi

Baza Ligjore: Nenet 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f ” dhe “n”, pika 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neneve 60, 61, dhe vijues të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, udhëzimit nr. 6, datë 23.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga administrata gjatë procesit të hetimit administrativ,

VËREN:

I.Vlerësimi Paraprak

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në portalin e denoncimeve, është raportuar nga Partia Demokratike, denoncimi me nr. ID të gjeneruar nga sistemi 2806, ndaj kandidatit për deputet z. Bledi Çuçi me pretendimin se, në qarkun e Gjirokastrës, ka hapur zyrën e tij elektorale në një distancë prej më pak se 100 metër nga QV nr. 4248, në kundërshtim me nenin 5 pika 1 të udhëzimit nr. 6, datë



Data: 21 Prill 2021
Nr. 269

Për shqyrtimin administrativ të denoncimit të Partisë Demokratike, për shkelje të parashikuara në udhëzimin nr. 6, datë 23.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ndaj kandidatit për deputet z. Bledi Çuçi

23.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Kjo zyrë ndodhet në Rrugën “Dr. Vasil Laboviti” kryqëzuar me rrugën “Lufta e Mashkullorës”, Lagjja “18 Shtatori”.

Sipas përcaktimeve të neneve 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kompetencat si më poshtë:

- dh) kujdeset për zbatimin e këtij ligji në mënyrë të drejtë, të përpiktë, të saktë dhe uniforme nga të gjitha institucionet, subjektet apo personat e ngarkuar me detyra dhe detyrime, sipas ligjit;
- f) monitoron nëpërmjet administratës së KQZ-së apo subjekteve të kontraktuara sjelljen e institucioneve publike gjatë fushatës dhe përdorimin e burimeve publike;
- n) ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia nje shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Referuar nenit 82 e vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve çmon se të dhënat e paraqitura nga subjekti kallëzues Partia Demokratike, përbëjnë indicie të besueshme për të filluar një procedurë administrative.

II. Rrethanat e faktit

Në datën 23.03.2021 Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ka miratuar udhëzimin nr. 6 “Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”.

Në datën 03.04.2021 , në portalin e denoncimeve nga Partia Demokratike, është raportuar denoncimi ndaj kandidatit për deputet z. Bledi Çuçi, për shkelje të këtij udhëzimi, duke pretenduar se kandidati ka hapur zyrën e tij elektorale në një distancë prej më pak se 100 metër nga QV nr. 4248, në kushndërshtim të plotë me çfarë ky udhëzim, parashikon.

Administrata e KQZ-së, përmes personit të autorizuar prej saj, ka verifikuar kallëzimin e bërë nga Partia Demokratike për Qarkun Gjirokastrë.

III. Analiza ligjore



Në vlerësim të provave dhe fakteve të sipërpërmendura, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhor çmon se:

Referuar nenit 5, të udhëzimit nr. 6 datë 23.03.2021 “Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, parashikohet se:

“1.Zyrat zgjedhore të subjekteve zgjedhorë mund të hapen në një distancë jo më të vogël se 300 (treqind) metra nga vendndodhja e KZAZ-ve, QV-ve dhe VNV-ve.

2. Subjekti zgjedhor njofton me shkrim Kryetarin e Bashkisë përkatëse dhe vë në dijeni KQZnë për hapjen e zyrave zgjedhore dhe për adresat e sakta të tyre, jo më vonë se 35 ditë para datës së zgjedhjeve.

3. Administrata e bashkisë përkatëse, jo më vonë se 5 ditë nga marrja e informacionit, bën verifikimin e vendndodhjes së zyrave elektorale dhe të respektimit të dispozitave të këtij udhëzimi për afishimin e materialeve propagandistike.

4. Policia bashkiake garanton zbatimin e detyrimit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni me kërkesë të KQZ-së.”

Për sa më sipër, në raportin e datës 17.04.2021, sjellë nga personi i autorizuar nga KQZ, për të kryer në terren verifikimin e fakteve të denoncuara nga Partia Demokratike, rezulton se:

Zyrat zgjedhore të hapura nga subjekti politik, Partia Socialiste dhe kandidati për deputet z. Bledi Cuci, në qendër të qytetit Gjirokastrë në lagjen “18 shtatori” posaçërisht në kryqëzimin e rrugëve Dr.Vasil Laboviti me rrugën “Lufta e Mashkullorës” janë në shkelje të nenit 5 pika 1 të udhëzimit nr. 6/2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Sipas raportimit, të dy këto zyra zgjedhore janë hapur në një distancë më të vogël se 300 metra nga vendndodhja e QV-ve, pikërisht afër qendrës nr. 4248 Shkolla “Koto-Hoxhi”.

Distanca e matur e zyrës zgjedhore të kandidatit Bledi Çuçi pranë shkollës “Koto Hoxhi” është 153 metra me google earth.

Distanca e matur e zyrës zgjedhore të Partisë Socialiste pranë shkollës “Koto Hoxhi” është 149 metra.

Referuar nenit 5 pika 4 të vendimit nr. 6/2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve parashikohet se:

“Policia bashkiake garanton zbatimin e detyrimit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni me kërkesë të KQZ-së.”



Në këto kushte, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, referuar nenit 5, pika 4 të udhëzimit nr. 6/2021, të sipërcituar, konstaton se mosmarrja e masave për mbylljen e zyrave zgjedhore të Partisë Socialiste dhe kandidatit për deputet z. Bledi Cuci, ngarkon me përgjegjësi policinë bashkiake të Bashkisë Gjirokastrë.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 60 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, udhëzimit nr. 6, datë 23.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve:

V E N D O S:

1. Policia bashkiake, të marrë masa të menjëhershme për të mbyllur zyrën zgjedhore të Partisë Socialiste afër qendrës nr. 4248, pranë shkollës “Koto Hoxhi” dhe zyrën zgjedhore të kandidatit për deputet z. Bledi Çuçi, afër qendrës nr. 4248 pranë shkollës “Koto Hoxhi”, në qarkun Gjirokastrë.
2. Kryetari i Bashkisë Gjirokastrë, të njoftojë menjëherë Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.
3. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen me postë elektronike denoncuesit.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

